

Martestat shqiptaro-serbe mes reprezentimeve mediatike dhe realitetit

Ishte vera e vitit 2008 kur për herë të parë në një gazetë shqiptare lexova një artikull mbi martesat e grave shqiptare në Serbi. Tema e artikullit kishte të bënte me dashurinë. Aty tregohet se si dy burra serbë nga zona e Sanxhakut ishin dashuruar e më pas martuar me dy gra shqiptare nga veriu i Shqipërisë. Dashuria mes dy grupeve kolektive, që zakonisht në gjuhën e folur emërtohen si popuj – pra mes serbëve dhe shqiptarëve, theksohet si një lloj reagimi simbolik ndaj të kundërtës, urrejtjes kolektive mes këtyre dy popujve. Qëllimi i artikullit ishte të tregonte se dashuria nuk pyet për asnjë lloj barriere. Me barrierë në rastin konkret nënkuptoheshin historia e dhimbshme e konfliktit dhe luftës në Kosovë, stereotipat negativë të shumtë, si dhe niveli i lartë i mosnjohjes së realiteteve sociale, ekonomike, kulturore e politike si të serbëve për Shqipërinë e Kosovën, ashtu edhe të shqiptarëve për Serbinë.

Që atëherë janë botuar shumë artikuj e reportazhe mbi këtë dukuri si në mediat serbe ashtu edhe ato shqiptare, si dhe janë realizuar disa dokumentarë. Ndërsa këta artikuj e dokumentarë japin informacione të nevojshme paraprake për të krijuar një ide mbi shpeshësinë dhe përhapjen gjeografike të këtyre martesave, shpesh, sidomos në rastin e mediave serbe, ata edhe kthehen në riprodhuese të diskurseve stereotipike në lidhje me ‘aftësinë dhe talentin e grave shqiptare për të qenë amvise të mira dhe gra të bindura’, përkundër ‘shturjes’ së grave fshatare serbe që preferojnë të lënë fshatin për të kërkuar rehatitë e jetës moderne në qytetet e mëdha, pa marrë përsipër angazhime serioze familjare siç është bindja ndaj familjes së burrit dhe qëndrimi në shtëpi për të rritur fëmijët. Ndërsa në median shqiptare duket se mbisundon më shumë njëfarë irritimi gjykues për këto gra dhe familjet e tyre, për të cilat aludohet të jenë shitur për 2.000-3.000 euro. Por nuk mund t’i fusim të gjithë artikujt në një thes, pasi çdo gjë varet nga serioziteti i mediave në fjalë. Kështu janë shkruar artikuj të gjatë dhe informues, siç është reportazhi i Dragana Nikoletićit “Bračna lutrija: Srbini i Albanka” botuar në “National Geographic Srbija”². Po ashtu artikujt dhe intervistat e dhëna nga Elona Xhepa në shtypin shqiptar dua t’i veçoj për shkallën e lartë të përgjegjësisë me të cilën e kanë trajtuar këtë çështje³.

¹ Armanda Hysa është antropologe nga Tirana. Ka doktoruar në Universitetin e Tiranës, ndërsa ka qenë hulumtuese dhe ligjëruese mysafire në Kolegjin Universitar në Londër, hulumtuese në Institutin Shqiptar për Folklor dhe drejtoreshë e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike të Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë. Hulumtimet e saj përfshijnë trashëgiminë osmane në Ballkan, posaçërisht çarshitë e vjetra dhe marrëdhëniet ndëretnike të shqiptarëve me serbët dhe maqedonasit, me fokus të veçantë në fenomenin e martesave të përziera mes meshkujve serbë dhe shqiptarëve nga veriu i Shqipërisë.

² <http://www.nationalgeographic.rs/reportaze/clanci/736.html> (tërhequr në 17. 03. 2015). Dëshiroj të falenderoj zonjën Nikoletić për ndihmën e dhënë për të kontaktuar çiftet e para të përziera në terren. Pa na njohur më parë, ajo nuk nguroi të na dërgonte numrat e celularëve që dispononte, duke na e bërë shumë të thjeshtë nisjen e kërkimit në terren.

³ Elona Xhepa dhe Katarina Gajić organizuan një ekspozitë me fotografi nga familjet e përziera shqiptaro-serbe në Tetor 2012 në Tiranë. Për më shumë shih <http://www.panorama.com.al/kuratorja-e-ekspozites-elona-xhepa-perse-behen-martestat-shqiptaro-serbe/> (tërhequr në 17. 03. 2015)

Por ka shumë artikuj të tjerë, sidomos të botuar në shtypin tabloid, të cilët u mëshojnë stereotipave të sipërpërmendur, dhe sidomos: a) diskursit të pjellorisë së grave shqiptare dhe b) faktit që fshatrat e jugut të Serbisë kanë mbetur pa gra që të mjelin lopët apo të kujdesen për pulat. Në këtë mënyrë prodhohet dhe riprodhohet imazhi i gruas shqiptare si një makinë riprodhimi – një imazh aspak i huaj ky për shqiptaret në Serbi, dhe si një shërbëtore pa gojë. Interesante është të vihet në dukje se shumica e artikujve të botuar në shqip nuk janë artikuj origjinalë, por janë përkthime të artikujve të sipërpërmendur nga mediat tabloide serbe, që shoqërohen nga tituj që kanë për qëllim të provokojnë ndjenja dhe reagime negative ndër shqiptarë, të tipit “Kurvrat e Shqipërisë në radhë për t’u martuar me pleqtë beqarë të Serbisë”, apo “Agjencitë organizojnë udhëtime për të gjetur burrë në Serbi⁴. Vajza: Na mashtruan, na thanë që do të shkojmë në Kroaci⁵”



Antropologia Armanda Hysa me një shqiptare të martuar në Serbi

Së dyti, dhe që është më e rëndësishme, zëri i vërtetë i grave të martuara në Serbi ose mungon, ose është i manipuluar në këto media. Kështu në mediat serbe duket sikur në shumicën e artikujve flet vetëm një grua që thotë të njëjtat fjalë: se ndihet e kënaqur me jetën në Serbi, se duhen shumë me burrin, se nuk kanë hasur në kurrfarë problemi dhe paragjykimi në shoqërinë pritëse. Ndërsa në mediat shqiptare zëri i tyre thuhetse mungon krejt, përveç ndonjë rasti ku gratë para kamerave dhe njerëzve të shtëpisë flasin si më lart, e pas kamerave tregojnë për një jetë të tmerrshme, për martesë me mashtrime, për përfshirje të mafisë së martesave në një masë të gjerë, etj.

Shpesh miqtë e mi, apo edhe njerëz të tjerë që e dinë se kam nisur një hulumtim të tillë më drejtohen të shqetësuar për të mësuar se si është e vërteta, nëse kemi të bëjmë me trafik të organizuar, apo nëse vërtet ka prindër në Shqipëri që shesin vajzat përkundrejt një shume të caktuar? Në këtë mënyrë nuk e kam luksin të jem thjesht një studiuese, është e pashmangshme që në njëfarë mënyre të kthehem në sqaruese të opinionit publik, e të përpiqem që të paktën kjo dukuri që ka thyer shumë kufij realë dhe mendorë e që po përbashkon me marrëdhënie krushqie dy krahina në Shqipëri e Serbi, të mos kthehet për të pafundmen herë në një objekt ndarjeje dhe konflikti. Kjo nuk do të thotë që të mbulohen rastet që kanë të bëjnë me mashtrimin, apo të mos vihet në dukje se ka njerëz të cilët duke instrumentalizuar nevojat e këtyre njerëzve përfitojnë materialisht. Në fund të fundit, si mund të pretendojmë se marrëdhëniet krejtësisht patologjike dhe anormale që ekzistojnë që në

⁴ <http://botasot.info/shqipëria/311524/kurvrat-e-Shqipërisë-në-rradhë-per-t'u-martuar-me-pleqtë-beqar-të-Serbisë-foto-Beograd/> (tërhequr në 17. 03. 2015)

⁵ <http://www.gazetatema.net/web/2014/07/05/dy-agjenci-martesore-dergojnë-dhjetëra-vajza-nga-Shqipëria-në-Serbi-ditën-e-vidovdanit-për-të-gjetur-burrë/> (tërhequr në 15. 07. 2015)

perceptim mes dy grupeve etnike do të mund të tejkaloheshin përmes rrugëve normale që janë thuajse inekzistente? Por mbetem e mendimit që para se të kërkojmë manipulimet e mundshme, duhet në radhë të parë të kuptojmë arsyet që çuan në lindjen e krijimit të këtyre krushqive të pazakonta, në një ambient ku e zakonshmja përbëhet nga paragjykimet dhe stereotipat negativë. Ajo pra që ne duhet të bëjmë është të mos humbim nga sytë kategorinë kryesore që është subjekti i kërkimit: kategorinë e njerëzve të vuajtur e me halle.

Për këtë arsye kërkimin mbi temën e martesave mikse shqiptaro-serbe e kam strukturuar në mënyrë të tillë, që analiza e diskursit mediatik të mund të ballafaqohet me realitetet komplekse në terren. Sanxhaku, Rashka, zona e Malit Javor, fshatrat nga kufiri me Malin e Zi e deri në Nova-Varosh e Ivanjice mbeten zonat me përqendrimin më të madh të çifteve mikse shqiptaro-serbe, megjithatë ato kanë përhapje tashmë në të gjithë Serbinë, nga Kurshumlja fqinje me Kosovën, Vranja, Nishi, Çaçaku, Uzice e deri në Sremska Mitrovica, në Vojvodinë. Ndërsa gratë shqiptare të martuara në Serbi vijnë më së shumti prej fshatrave të Lezhës, Shkodrës e Pukës dhe janë krejt katolike, me ndonjë përjashtim tepër të rrallë. Është vështirë të pohosh me siguri se sa është numri i këtyre martesave, por kreu i organizatës humanitare “Stara Raska”, Vojin Vuçiçeviq pohon se bëhet fjalë për rreth 350 martesë të tilla në të gjithë Serbinë. Deri më tani kam piketuar 13 raste studimore. Synimi im ka qenë që, përpara se të hulumtoj sipas tematikave të caktuara, duhet të njihem mirë dhe imtësisht me situatat dhe kushtet që bënë të mundur nisjen dhe realizimin e këtyre martesave.

Këto dhe shumë pyetje të tjera të planifikuara, por edhe të paplanifikuara, që dalin nga bisedat, si dhe rrëfimet jetësore të grave e burrave të cilëve u kam marrë intervistë, ose me të cilët kam biseduar, përbëjnë një material gati mahnitës për të njohur realitetet e dy zonave në fakt periferike të dy shteteve, Shqipërisë dhe Serbisë. Në çdo bisedë e intervistë ka potencial për të zhvilluar hulumtim tematik mbi shumë tema të ndryshme, si p.sh. raportin qendër-periferi, kalimin dhe thyerjen e barrierave mendore e kufijve realë që ekzistojnë mes shqiptarëve dhe serbëve, gjendjen reale dhe statusin e grave në këto dy zona, si dhe përfaqësimin e këtij statusi në diskurs, marrëdhënien patriarkalitet –maskulinitet, nivelet e ndryshme të patriarkalitetit, marrëdhënien mes shkollimit dhe nacionalizmit, etj. Do të doja të shkruaja gjatë për këtë material, për të dhënat e mbledhura deri tani, por këtu do të ndalem në dy momente që kanë qenë edhe shumë prekëse për mua si antropologe në terren, që përbëjnë dimensionin human të këtij kërkimi e që janë shumë domethënëse, pra pikërisht për atë që përmenda më sipër, për kategorinë e njerëzve me halle.

Rasti 1.

Takimi me M. dhe D. në një prej fshatrave të Sanxhakut. Kur arrita, D. më priste me një gëzim që nuk e fshihte dot. Më shtrëngonte fort, e më përsëriste:

– Ke ardhë nga Tirana me më pa, ke ardhë nga Tirana me na pa, motër të kam.

Ndërkohë ra telefoni. D. tha në shqip:

- Po po erdhi, ja ktu me mu e kam... e do t'i them që të vijë dhe ke ty, eeeee ka ardhë me na pa, ka ardhë me u interesu për na, nuk na kanë haru bre, kujdeset shqiptari për njerzt e vet – eeejjj Sali Berisha, nuk na ka haru qeveria, ka çu njerz me na pa.

E habitur me çka dëgjoja e pyeta D. si qe puna. Fakti është që mes grave shqiptare të martuara në disa fshatra të Javorit e Sanxhakut ishte krijuar një rrjet miqësie. Një pjesë e mirë e tyre flisnin në telefon çdo ditë në shqip, edhe pse nuk ishin takuar kurrë

personalisht. Dikush kishte hapur fjalën se së shpejti qeveria shqiptare do të dërgonte dikë për të parë se si jetonin ato në Serbi. Një shpresë e madhe fshihej pas artikullimit të këtyre fjalëve, që nuk kishte të bënte me shpresën për ndihmë financiare, por me shpresën se ato nuk ishin të harruara mes malesh, se dikush kujdesej për to....dhe mua me erdhi keq që m'u desh t'ia prishja atë, nuk isha personi që prisnin! Më erdhi keq madje se m'u desh ta sqaroja se këto janë vetëm fjalë....

Jo – tha! Njësoj është. Ti ke ardhë me na pa, me u interesu për ne. Njësoj asht, ti je motra jonë.

M. bënte kafetë, D. skuqte patatat dhe bënte shaka me vjehrrin për arsyen pse shumë burra në fshat rrinë pa martuar, edhe pse ka plot vajza të pamartuara. Vjehrrin kujdesej për vajzat 4 dhe 2-vjeçare. Në një moment kur në dhomë ishin vetëm dhe unë hyra pa zhurmë, plaku R. i thoshte mbesës: “Sunce moj – kazi: ja cu biti dobar covek”... dhe këtë e thoshte me qetësinë e një njeriu që duket se posedonte botën. Me pas R. nisi të tregonte se personi që e kishte gjetur D. i kishte keqtrajtuar, me të kishin pasur shumë probleme dhe që kishin humbur shumë para. (Personi ndërmjetës siguronte taksinë, ryshfetin për të kaluar kufirin pa vizë, dhe po ashtu shenjat e florinjta të fejesës dhe për këto shërbime kërkonte një shumë të caktuar, por kjo shumë me keqdashësi manipulohet në mediat shqiptare e paraqitet si një shumë që dhëndurët ua paguajnë baballarëve shqiptarë për t'ua blerë vajzat).

– Ai person – tha – meriton dënim, por unë nuk do të resht kurrë së falënderuari atë. E çfarë rëndësie ka që ai njeri na rropi nga paratë e na torturoi? Çfarë do të kishte ndodhur me mua dhe M. po të mos ishte ai? Do të kishim mbetur dy qyqare të vetmuara, dhe sigurisht që do të kishim mbetur pa to, - tha duke parë nga mbesat. Nëse çmimi për të pasur këto mrekulli ishte të na mundonte një njeri i keq, atëherë ai mundim ia ka vlejtur....

Rasti i dytë – takimi me gruan e parë të martuar në Serbi.

V. kishte dhe një kunatë po shqiptare. Pasi kaloi frika dhe merakun se mos isha gazetare, i bëra të parës grua shqiptare të martuar në Serbi të fala prej mikut të përbashkët, R. Në vitin 2006, R. bënte punën e terrenit në Peshter, me lahutarët e zonës. Kur e marrin vesh se ishte shqiptar, i thanë se kishin nevojë për të në një familje të zonës, pasi nusja shqiptare nuk dinte asnjë fjalë serbisht... ‘Para se të martohesha as nuk më shkonte mendja se do të vija në këtë humbëtirë. Kisha mendu se vendi ma i keq jashtë, asht shumë ma mirë se vendi ma i mirë n’Shqipni’... R. kishte shkuar aty dhe i kishte bërë një tip fjalorthi fillestar, e i kishin qarë hallet bashkë... Kur i thashë asaj se i bëja të fala prej R, ajo më përqafoi fort... ‘oh’ tha, ‘unë në atë kohë vetëm qaja, nuk dija ku isha... bëra kafet për mysafirin e kur ai me përshëndeti në shqip, kafet me ranë nga dora dhe u shkruva në vaj... nuk e mbaj mend as çka më tha e as çfarë i thashë, di vetëm që më digjte malli dhe që u shkruva në lot... kurrën e kurrës nuk kam me e harru atë djalë, edhe ai me pati thënë se nuk do të më harronte dhe ja e mbajti fjalën...’ e kështu mes lotëve nisën të kujtonin ato gra kujtimet nga muajt e parë të jetës në fshatin serb... tani kishin 5 fëmijë, dy njëra e tre tjetra, kishin ndërtuar shtëpinë, me burrat shkonin shumë mirë - dhe ishte e qartë, nuk kishte nevojë për shumë fjalë... por kujtimet e

* Ana Petrov je muzikološkinja i sociološkinja, docentkinja na Fakultetu za medije i komunikacije u Beogradu. Doktorat iz sociologije muzike odbranila je na Filozofskom fakultetu u Beogradu. Objavila je knjige *Bruno Latur* (Beograd, 2015), *Pjer Burdije* (Beograd, 2015), *Rethinking Rationalisation. Evolutionism and Imperialism in Max Weber's discourse on Music* (Wien, 2016), *Jugoslovenska muzika bez Jugoslavije. Koncerti kao mesta sećanja* (Beograd, 2016), kao i niz članaka u domaćim i međunarodnim naučnim časopisima.

fillimit na përlo të shumë që të triave... Nuk besoj se mund të bësh kërkim kualitativ mbi gratë në ambiente patriarkale e të mos kalosh çaste të tilla...

Nga të gjitha rastet e marra në shqyrtim është e qartë se pagesa që aq shumë përflitet nëpër media nuk është "çmimi i nuses", këtu nuk kemi të bëjmë me një proces shitblerjeje, por është çmimi për ndërmjetësit, qofshin agjenci apo njerëz, sikurse ndodh në çdo vend të botës. Probleme mund të kenë lindur me ndonjë ndërmjetës, kur nuk i ka kryer shërbimet si duhet e nuk i ka kthyer paratë mbrapa, por ky nuk është një problem që prek martesat në vetvete. Madje disa nga gratë nuk harruan të më theksonin se sa shumë të fyera janë ndier nga mediat sa herë që është prekur një problem i tillë. Dëshira dhe nevoja për të krijuar familje, si dhe frika e një jete të kaluar në vetmi i kanë kaluar barrierat rixhide që i përmenda më sipër. Ato meritojnë të jenë fillimisht në qendër të vëmendjes për të kuptuar më pas çdo gjë tjetër në lidhje me këto martesat.

Këto ngjarje në terren të ndihmojnë të mendosh përtej kategorive popuj-miq apo armiq. Të gjitha ato çështje që i përmenda më sipër janë tema tepër interesante për hulumtim, por terreni na kujton dhe rikujton me insistim që ky hulumtim kurrë nuk duhet të humbë nga shikimi kategorinë e njerëzve me halle. Ky është parakushti për mendimin tim që pasqyrimi mediatik e studimi i martesave shqiptaro-serbe të bëhen përtej paragjyqimeve apo emocioneve që ne si autorë, qofshim gazetarë apo studiues, serbë apo shqiptarë, kemi si pjesë e shoqërive ku jetojmë...